

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8295
E mërkurë, 6 maj 2026
Çmimi 0.50 €

Gucati niset për Gjykatën Speciale me 200 mijë nënshkrime

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTA E THAÇIT PËR "OPINION": KY PROCES KA DEVIJUAR NGA MISIONI, DUHET TË OFROHET DREJTËSI E JO HAKMARRJE E BAZUAR NË MASHTRIM

FAQE 4-5



- "Aktualisht më është mbyllur goja për të folur dhe më janë lidhur duart për të shkruar atë që ma do zemra e ma thotë plotësisht mendja", Hashim Thaçi

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dhënë një intervistë për emisionin "Opinion" nga paraburgimi në Hagë, ku ndodhet që nga viti 2020 së bashku me ish-drejtuesit e tjerë të UÇK-së,

Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputeti Rexhep Selimi. Drejtuesi i emisionit, Blendi Fevziu, i ka drejtuar pyetjet për Thaçin që nga muaji janar, por për shkak të procedurave përgjigjet kanë

ardhur disa muaj me vonesë. Ish-presidenti i Kosovës ka folur në këtë intervistë për ecurinë e procesit gjyqësor dhe qëndrimet që ai ka në lidhje dëshmitarët dhe mënyrën se si po zhvillohet gjyqi



RAMA PA 'LEJEN' E LDK-së ZYRTARIZON KOALICIONIN ME PDK-në PËR QEVERISJE NË PRISHTINË F. 3



DNV-ja: RREGULLORJA E RE E KOZ-së PËR VËZHGUESIT KUFIZON VËZHGIMIN E PAVARUR TË ZGJEDHJEVE F. 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



EKONOMIA E IRANIT, BUZË GREMINËS PËR SHKAK TË LUFTËS F. 2

VOTOHET ME 58 VOTA PËR RAPORTI I PE-së PËR SHQIPËRINË F. 6

HAPET ZYRTARISHT GJYKATA ADMINISTRATIVE F. 7

EKONOMI



RAPORTI I FMN-së NJEH PËRPARIMIN NË FORCIMIN E KORNIZËS SË STABILITETIT FINANCIAR TË KOSOVËS F. 8

RRITEN TË HYRAT E QEVERISË NË VITIN 2025 KRAHASUAR ME VITIN 2024 F. 8

SPORT



PRISHTINA E RE - PRISHTINA HAP XHIRON E 33-të NË SUPERLIGË F. 11

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

EKONOMIA E IRANIT, BUZË GREMINËS PËR SHKAK TË LUFTËS

TEHRAN, 5 MAJ - Ekonomia e Iranit ka hasur në vështirësi tash e shumë vjet për shkak të sanksioneve ndërkombëtare dhe keqmenaxhimit administrativ. Por, gjendja është përkeqësuar edhe më shumë pasi Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën sulmet më 28 shkurt.

Infrastruktura veçse e rrënuar ishte në shënjestër të sulmeve, duke bërë që fabrika e uzina çeliku të dalin jashtë funksionit, ndërsa ura e porte të jenë të papërdorshme.

Edhe më keq se kaq, janë goditur objektet e naftës dhe gazit, ndërsa bllokada e tanishme amerikane ndaj porteve iraniane e ka ndërprerë pothuajse plotësisht burimin kryesor të të ardhurave të Teheranit: paratë nga nafta.

Duke qenë se monedha ka rënë në nivele historikisht të ulëta kundrejt dollarit dhe ndërprerja e internetit ka paralizuar bizneset, analistët thonë se ekonomia e Iranit ndodhet tani në një territor të panjohur. "Pra, nëse regjimi nuk kërkon lëshime nga ShBA-ja për ta hequr bllokadën, ekonomia do të mbetet jashtëzakonisht e dobët", tha Jason Tuvey, zëvendëskryeekonomist për tregjet në zhvillim në Capital Economics me seli në Londër. "Por, në fund, gjithçka varet nga niveli i dhimbjes ekonomike që regjimi iranian është i gatshëm ta përballojë për t'i arritur synimet e veta ushtarake dhe gjeopolitike", shtoi ai.

Gjendja është përkeqësuar aq shumë saqë zyrtarët e lartë nuk

mund ta mohojnë më demin.

Thuhet se guvernatori i Bankës Qendrore të Iranit, Abdolnaser Hemmati, i ka kërkuar presidentit Masud Pezeshkian të ndërmarrë hapa urgjentë për ta stabilizuar ekonominë, përfshirë rikthimin e qasjes së plotë në internet dhe arritjen e një marrëveshjeje për paqe me Uashingtonin.

Zëdhënësja e qeverisë, Fatemeh Mohajerani, ka vlerësuar se dëmet e përgjithshme në infrastrukturë dhe në pronat e banimit dhe tregtare nga lufta kapin shifrën e 270 miliardë dollarëve. Kjo shifër është nëntë herë më e lartë se i gjithë buxheti publik i Iranit për vitin 2025 dhe afërsisht 60 për qind e prodhimit ekonomik të vendit, sipas faqes ekonomike "Eqtesad News".

Zyrtarët iranianë vlerësojnë se kostot e rindërtimit do të arrijnë në rreth 300 miliardë dollarë vetëm për infrastrukturën civile, ndërsa kosto të tjera do të vijnë nga ndërprerjet e tjera ekonomike, si humbja e bizneseve dhe nevoja për rritje të pagesave sociale.

Sipas Gholamhossein Mohammadi, zëvendësministër i Punës në Iran, vlerësimet paraprake tregojnë se konflikti ka çuar në humbjen e më shumë se një milion vendeve të punës dhe ka lënë dy milionë njerëz të papunë drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Koha e luftës e ka përkeqësuar edhe më shumë tregun e punës të Iranit.

Sipas së përditshmes ekonomike iraniane, "Donya-e

Eqtesad", pranvera është tradicionalisht sezoni kulmor i punësimit. Platforma e punësimit Iran Talent thotë se një muaj tipik pranvere prodhon rreth 65 000 vende të lira pune. Këtë vit vendet e reja të punës kanë rënë 80 për qind. Për çdo pesë vende pune që hapeshin pranverën e kaluar, katër tani janë zhdukur.

Sa iu përket kërkesave për punë, shifrat janë po aq të larta. Më 5 maj platforma e punësimit Jobvision regjistroi një rekord ditor prej 318.000 CV të dorëzuara nga punëkërkuarit, pra 50 për qind më shumë se rekordi i mëparshëm prej 212.000 sosh.


Hendeku midis atyre që kërkojnë punë dhe vendeve të hapura të punës nuk ka qenë kurrë më i madh.

Ndërkohë, analistët thonë se shkatërrimi i ekonomisë është përkeqësuar nga ndërprerja e internetit e vendosur nga shteti, tani në ditën e 66.

Kjo ndërprerje i kushton ekonomisë digjitale të Iranit midis 30 dhe 80 milionë dollarë çdo ditë, duke shkatërruar tregtinë elektronike, logjistikën dhe sektorin e teknologjisë, pa përmendur sipërmarrësit e vegjël, bizneset e të cilëve janë ndalur plotësisht.

Në një shenjë shqetësimi në rritje, Unioni i Prodhimit dhe Publikimit të Përmbajtjes, që përfaqëson bizneset që operojnë në hapësirën digjitale, ka bërë thirrje për qasje të sigurt në internet për iranianët.

Në një deklaratë të formuluar me kujdes më 4 maj, unioni tha



se, megjithëse mbështet vendimet e qeverisë në kushte emergjente, çdo politikë në këtë fushë duhet të zhvillohet me pjesëmarrjen e sektorit privat. "Jeta e miliona iranianëve e ndërtuar mbi baza digjitale nuk duhet të bëhet lodër e interesave përçarëse politike", thuhej në deklaratë.

Riali iranian ka rënë në mënyrë të theksuar paralelisht. Monedha tani tregtohet rreth 1.9 milion riali për vetëm një dollar në tregun e lirë, më shumë se dyfishi i vlerës së saj një vit më parë, sipas TGJU, një platformë që gjurmon tregun e arit dhe këmbimit valutor në Iran.

Duke qenë se të ardhurat nga nafta i janë ndalur nga bllokada detare amerikane dhe bizneset nuk janë në gjendje për të gjeneruar të ardhura të tatueshme, qeveria përballet me një krizë strukturore financimi. Duke folur për Radion Farda të REL-it, Dalga Khatinoglu, ekspert i energjisë për Iranin me bazë në Azerbajxhan, tha se Irani duhet ta ulë prodhimin e

naftës dhe gazit nëse bllokada vazhdon, sepse po i mbaron kapaciteti i magazinimit. Ai vlerësoi se, nëse bllokada amerikane vazhdon edhe për një muaj tjetër, prodhimi i naftës në Iran do të bjerë për 1.2 milion fuçi në ditë. "Kjo do të jetë shumë e dhimbshme për Iranin", tha Khatinoglu.

Pasojat fiskale shtrihen përtej humbjes së prodhimit.

Ekonomisti iranian Majid Salimi Borujeni, duke shkruar në të përditshmen ekonomike "Jahan-e-Sanat", paralajmëroi se çdo rritje e të ardhurave nga nafta për shkak të çmimeve më të larta gjatë mbylljes së Ngushticës së Hormuzit është e përkohshme dhe se kostot e rindërtimit pas luftës do ta tejkalojnë shumë atë. Me mungesë burimesh të besueshme të të ardhurave, ai argumentoi se financimi monetar i deficitit - praktikisht shtypja e parasë - mund të jetë e vetmja rrugë e mbetur, një rrugë që rrezikon ta përshpejtojë inflacionin që tashmë ka kaluar mbi 70 për qind.

SARAJEVA PËRKUJTON FËMIJËT E VRARË GJATË RRETHIMIT 1992-1995

SARAJEVË, 5 MAJ - Në Kantonin e Sarajevës, 5 maji është ditë zie në kujtim të fëmijëve të vrarë të Sarajevës gjatë luftës në Bosnjë-Hercegovinë në vitet '90. Sipas të dhënave zyrtare, 1 601 fëmijë u vranë gjatë katër vjetëve të rrethimit të Sarajevës (1992-1995).

Sipas vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe vendore, së paku 53 prej tyre janë vrarë nga snajperët, ndërsa më shumë se 14 mijë janë plagosur. Për krimet ndaj fëmijëve të kryera gjatë rrethimit, deri më tani nuk është mbajtur askush përgjegjës.

Qeveria e Kantonit të Sarajevës në vitin 2019 ka marrë vendim që 5 maji të shënohet si Dita e Kujtimit për Fëmijët e Vrarë të Sarajevës.

Muzeu Historik i Bosnjë-Hercegovinës që nga shkurti i vitit 2020 po mbledh sende personale të fëmijëve të vrarë

gjatë rrethimit të Sarajevës, të cilat janë ekspozuar në kuadër të instalacionit memorial "Dhoma e Bardhë".

Terrori ndaj qytetarëve të Sarajevës zgjati 1 425 ditë. Sipas vendimeve të Gjykatës në Hagë, sulmet ndaj civilëve nga pozicionet e Ushtrisë së Republikës Sërpska ndodhnin kudo dhe në çdo kohë të ditës apo natës.

Për rrethimin e Sarajevës, Gjykata Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Hagë ka dënuar me burgim të përjetshëm Stanislav Galliçin, ndërsa Dragomir Millosheviq është dënuar me 29 vjet burg.

Të dy ata kanë qenë komandantë të Korpunit Sarajevë-Romanija, i cili e ka mbajtur qytetin nën rrethim për 44 muaj.

Disa pjesë të dënimeve të përjetshme të Radovan Karaxhiqit, ish-president i



Republikës Sërpska, dhe Ratko Mlladiqit, ish-komandant i Ushtrisë së Republikës Sërpska, lidhen me terrorizimin e popullsisë civile të Sarajevës. Në nivel vendor për krimet në pjesët e rrethuara të qytetit janë

ndjekur deri tani 12 persona. Para Tribunalit të Hagës është akuzuar edhe ish-presidenti i Serbisë, Slllobodan Millosheviq, por ai ka vdekur gjatë procesit, në mars të vitit 2006, dhe gjykimi është ndërprerë.

Bilana Pllavshiq, ish-presidente e Republikës Sërpska, ka pranuar fajësinë për pjesëmarrje në krimet në Sarajevë dhe është dënuar me 11 vjet burg nga Gjykata e Hagës.

Gucati niset për Gjykatën Speciale me 200 mijë nënshkrime

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Guçati, ka njoftuar se është në rrugë drejt Hagës, bashkë me mikun e tij, bashkëluftëtarin Ali Mejzinolli, jo thjesht si udhëtarë, po si bartës të amanetit dhe vullnetit të një populli. “Në duart tona mbajmë petitionin me 200 mijë nënshkrime, 200

mijë dëshmi gjallë, 200 mijë thirrje për drejtësi që do të dorëzohen në Gjykatën Speciale. Aty, ku sot po mbahen padrejtësisht ata që nuk u thyen kurrë, krerët e UÇK-së dhe themeluesit e shtetit të Kosovës. Ky udhëtim nuk është vetëm për individët, por për mbrojtjen e pastërtisë

së luftës sonë çlirimtare. Nuk mund të gjykohej liria. Nuk mund të pritet në pranga e vërteta e një kombi që u ngrit nga hiri për t’i dalë zot vatanit. 200 mijë nënshkrime janë 200 mijë goditje mbi padrejtësinë”, ka shkruar Guçati në “Facebook”. Ai ka thënë se liria ka emër, liria ka

dëshmitarë, dhe populli i Kosovës nuk harron e as nuk dorëzohet. “Drejtësia mund të vonojë, por ajo është e pashmangshme, sepse dielli nuk mbulohet me shoshë. Me kokën lart, për historinë tonë, për shtetin tonë, për çlirimtarët tanë!”, ka shkruar Guçati.



RAMA PA ‘LEJEN’ E LDK-së ZYRTARIZON KOALICIONIN ME PDK-në PËR QEVERISJE NË PRISHTINË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar të martën për bashkëqeverisje me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) në kryeqytet. Ai ka thënë se Besianë Musmurati që vjen nga PDK-ja është emëruar në pozitën e nënkryetares së kryeqytetit. “Po fillojmë një bashkëpunim të ri politik në kryeqytet edhe me Partinë Demokratike të Kosovës me qëllim zhvillimin e Prishtinës, për të mirën e qytetarëve të saj dhe të Kosovës. Zotohemi për qeverisje që tejkalon interesat

partiake, duke vënë në dispozicion kapacitetet profesionale dhe njerëzore për realizimin e projekteve strategjike në dobi të qytetarëve dhe të mirës publike. Nga sot, Besianë Musmurati emërohet në pozitën e nënkryetares së kryeqytetit, duke sjellë me vete përvojë të gjerë institucionale dhe ndërkombëtare”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka theksuar se me një angazhim mbi një dekadë në fusha si diplomacia, politika publike dhe menaxhimi institucional, Musmurati ka kontribuar në avancimin e proceseve vendimarrëse dhe përfaqësimin e Kosovës në

arenën ndërkombëtare. “Përvoja e saj në kryeqytet, veçanërisht në drejtimin e Arsimit, ka lënë gjurmë në përmirësimin e cilësisë dhe krijimin e kushteve më të mira për nxënësit dhe mësimitdhënësit. I urojmë suksese në këtë përgjegjësi të re, në shërbim të qytetarëve të kryeqytetit”, ka shkruar i pari i Prishtinës, Përparim Rama. Pavarësisht që Rama ka njoftuar për këtë koalicion, LDK-ja përmes një komunikate për medie ka mohuar një marrëveshje për bashkëqeverisje me PDK-në në kryeqytet. “LDK-ja njofton opinionin publik se nuk ka asnjë marrëveshje me PDK-në dhe asnjë parti tjetër

politike në Prishtinë për bashkëqeverisje. LDK-ja nuk ka marrë pjesë në asnjë proces ndërpartiak për ndonjë marrëveshje bashkëqeverisëse politike deri më tani. LDK-ja ka strukturat e veta partiake, organet vendimarrëse lokale dhe më gjerë; dhe këto struktura nuk kanë qenë pjesë e asnjë marrëveshjeje qeverisëse. Çdo marrëveshje tjetër nuk përfaqëson qëndrimin zyrtar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Si e tillë, ajo nuk krijon obligime politike për LDK-në dhe nuk mund të konsiderohet si vullnet i organizuar i saj. Palët dhe subjektet e tjera politike e dinë shumë mirë se si ndërtohen

marrëveshjet ndërpartiake me LDK-në; përmes strukturave zyrtare, transparencës dhe vendimmarrjes institucionale. Çdo përpjekje për ta anashkuar këtë rrugë nuk përbën marrëveshje me LDK-në”, theksohet në komunikatën e LDK-së. Komunikata vazhdon se për çështjet e tjera lokale LDK-ja do të angazhohet pas zgjedhjeve nacionale. “Në këtë fazë LDK-ja dhe anëtarësia e saj janë të angazhuar plotësisht në procesin e ringritjes së përbashkët. Asnjë agjendë tjetër nuk mund ta zbehë këtë përkushtim”, thuhet më tutje në komunikatën e LDK-së.

Agjencia e Kosovës për Akreditim pranohet zyrtarisht në ShBA

PRISHTINË, 5 MAJ - Bordi i Këshillit për Akreditimin e Arsimit të Lartë (CHEA) në ShBA e ka pranuar për shtatë vjet (deri me 31.12.2033) Agjencinë e Kosovës për

Akreditim, me statusin e “autoritetit akreditues” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në njoftimin zyrtar të dërguar drejtorit të përgjithshëm të AKA-së,

Naim Gashi, Loretta C. Waldron, zëvendëspresidente për Shërbime të Njohjes në Këshillin për Akreditimin e Arsimit të Lartë në ShBA, konfirmon se “Bordi i

Drejtorëve të CHEA-s ka miratuar rekomandimin e Komitetit dhe e ka njohur Agjencinë e Kosovës për Akreditim si autoritet akreditues”.





INTERVISTA E THAÇIT PËR 'OPINION': KY PROCES KA DEVIJUAR NGA MISIONI, DUHET TË OFROHET DREJTËSI E JO HAKMARRJE E BAZUAR NË MASHTRIM

- "Aktualisht më është mbyllur goja për të folur dhe më janë lidhur duart për të shkruar atë që ma do zemra e ma thotë plotësisht mendja", Hashim Thaçi

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dhënë një intervistë për emisionin "Opinion" nga paraburgimi në Hagë, ku ndodhet që nga viti 2020 së bashku me ish-drejtesit e tjerë të UÇK-së, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, dhe ish-deputeti Rexhep Selimi. Drejtuesi i emisionit, Blendi Fevziu, i ka drejtuar pyetjet për Thaçin që nga muaji janar, por për shkak të procedurave përgjigjet kanë ardhur disa muaj me vonësë. Ish-presidenti i Kosovës ka folur në këtë intervistë për ecurinë e procesit gjyqësor dhe qëndrimet që ai ka në lidhje dëshmitarët dhe mënyrën se si po zhvillohet gjyqi

PRISHTINE, 5 MAJ - I devijuar nga misioni i drejtësisë. Kështu e përshkroi ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, procesin gjyqësor në Hagë ndaj tij dhe ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në një intervistë me shkrim për emisionin "Opinion" me Blendi Fevziun, duke cituar profesorin

amerikan Daniel Sewer. Ai tha se gjykata duhet të ofrojë drejtësi dhe jo "hakmarrje të bazuar në mashtrim". Thaçi shprehu besimin se, pas dëgjimit të dëshmitarëve të Prokurorisë dhe atyre të mbrojtjes, gjykatësit do të nxjerrin një vendim të drejtë dhe meritohet. Ai kujtoi se ky proces nuk lidhet vetëm me

fatim e tij personal, por edhe me historinë e rezistencës dhe lirisë së Kosovës. Duke folur për jetën në Hagë, ai tha se po kalon vitin e gjashtë në izolim pa vendim gjyqësor, ndërsa qëndrimin atje e përshkroi si shkëputje të gjatë nga jeta familjare, publike dhe institucionale. "Në izolim po kaloj vitin e

gjashtë pa vendim gjyqësor. Siç theksoi së fundmi eksperti politik amerikan Daniel Serwer, ky proces ka devijuar nga misioni. Duhet të ofrohet drejtësi e jo hakmarrje e bazuar në mashtrim. Nga ana ime, nuk kam çfarë t'i shtoj këtij konstatimi", ka theksuar Thaçi. I pyetur se cilat janë vërejtjet që ka në lidhje me zhvillimet e procesit?, Thaçi ka theksuar se ky proces do të duhej të ishte transparent. "Të ishte transparent, llogaridhënës, me mekanizëm kujdestarie, të respektohej barazia e palëve, të drejtat e njeriut e, mbi të gjitha, legjislacioni i Kosovës, mbi bazën e të cilit është themeluar kjo gjykatë. Ndjekja penale të respektonte parimet

themelore të kodit të etikës, që të ndiqej e vërteta kudo që të çon ajo, duke përfshirë edhe dëshmitë shfajësuese". A besoni në pafajësinë tuaj, sidomos pasi u njohët me paraqitjen e dëshmitarëve të akuzës?, pyeti Fevziu Thaçin në intervistën e realizuar me shkrim: "Plotësisht. Historia e lirisë së Kosovës prej fillimeve të viteve 1980 e deri sot është thelbi i këtij procesi. Unë jam vetëm instrument në këtë eksperiment juridik. Nxjerrja e aktgjykimit është në duart e gjykatësve, por unë kam besim që, pas dëgjimit të dëshmitarëve të Prokurorisë e, në veçanti, atyre të mbrojtjes, të profilit dhe kredibilitetit më të lartë ndërkombëtar, ata do të nxjerrin vendim të drejtë

dhe merit. Shumëçka lidhur me legjitimitetin e së drejtës penale ndërkombëtare varet nga rezultati i këtij procesi”.

Si është dita e Thaçit në izolim prej gjashtë vjetësh

Ish-presidenti Thaçi është përgjigjur edhe në pyetjen se si është një ditë e tij në izolim prej gjashtë vitesh. “Aktualisht më është mbyllur goja për të folur dhe më janë lidhur duart për të shkruar atë që ma do zemra e ma thotë plotësisht mendja. Në këtë vështrim, Blendi, do të mundohem të bëj më të mirën për rrethanat ku gjendem. Serbia u mor e merret kohë të gjatë me mua. Më dënoi në mungesë me shumë vite burg. Në mënyrë të vazhdueshme, 1993-1997, bastisi shtëpinë, keqtrajtoi dhe arrestoi babanë, nënën, motrën dhe vëllezërit. Në shenjë hakmarrjeje, ekzekutoi edhe vëllanë e Lumës, Hakiun, në masakrën e fshatit Studime të Vushtrrisë, në maj 1999. Në qershor 1999, lufta përfundoi. I takoj botës së shqiptarëve të mbijetuar. Sot faji im i vetëm është pse jam gjallë. Nuk i takoj kategorisë së njerëzve që thonë se burgu është për burra. Kjo shprehje më duket bezdisëse. Nuk jam altruist as asket. E kam bërë jetën, nuk jam fshehur prej saj. E kam ndjekur ritmin e maratonës. Rruga ime nuk ishte as fat e as rastësi. Është qëllim që buron nga thellësia e botës sime. Është e prekshme dhe transparente. Qysh herët e kisha vendosur gjithë qenien time në funksion të idesë së lirisë. Vetmia natyrshëm më jep zbrazëti dhe më ofron kotësi. Mundohem t'i jap shpirt ambientit në qeli. 24 orët e ditës dhe 365 ditët e vitit janë të njëjta. Humb kumtimi kalendarik i jetës. Ditënetët sikur kalojnë pa data. Kam reflektuar për Kosovën, për Shqipërinë dhe shqiptarët, për sjelljen e botës në fillim dhe në fund të shekullit XX në raport me ne. Jo rrallë harrojmë sa të plandosur dhe të nëpërkëmbur kemi qenë. Jo rrallë të trajtuar edhe si mbetje otomane. Ndërsa sot, sa lart jemi në ngritje dhe proces konsolidimi si komb me mendim dhe status perëndimor. Liria dhe burgu nuk ngjiten kurrë. Nuk i ndan vetëm muri fizik, por emocioni, të menduarit dhe mënyra se si e sheh, ndien dhe jeton botën. Izolimi është zgafellë me mungesë horizontesh dhe ashensori. Kjo kalamendje fizikisht, e besa edhe mund të të verbojë, jo për nga niveli i dioptrisë, por i ngatërrimit apo mënyrës se si ishin gjërat”, ka pohuar Thaçi.

Ai ka shtuar se koha dhe distanca e bëjnë të vetën tek çdo njeri, sado rezistues që të jetë. “Por, falë Zotit dhe vetëkujdesit, ende jam mirë. Për gati gjashtë vite nuk kam pasur grip, ethe, temperaturë e as ftohjen më të vogël, përjashto Covid-19. Ndihej i bekuar që kam ecur luginave e

shpatieve, kam shkelur lartësitë dhe të poshtat e bjeshkëve tona në etapat më të mira të jetës. I kam përjetuar fizikisht dhe emocionalisht shkëlqimin e rrezeve të diellit, acarin me erë e borë, rrebeshet e shiut nëpër shtigje dhe rrugica me llucë. Këto hapa një kohë i kam bërë si sakrificë për liri e më vonë nga pasioni për natyrën. I njoh thujtë pëllëmbë për pëllëmbë. Më mban ajri, fryma dhe energjia e atdheut. Kjo ka bërë që ta ndiej edhe më thellësisht dhe gjerësisht jetën, vendlindjen e ende shok të kthjellët. Përfjetoj në horizont të plotë. Për mua është shëndet, dashuri, besim dhe krenari. Por jetës së shëndetshme i duhet përmbajtja. Kjo tani më mungon. Në izolim sulmohem nga mijëra e mijëra drithërime mendimesh që sillen vërdallë. Nuk dinë nga të vijnë, si t'i frenosh e në ç'drejtim t'i orientosh. Mundohem që idetë dhe botën reale t'i përputh me njëra-tjetrën. E kam të kultivuar përvojën individuale të lirisë psikologjike edhe në rrethana të shtrëngimit fizik. Çdo ndjenje të keqe i përgjigjem me emocion, me mendje alternative. Përpiqem t'u jap substancë, formë dhe drejtim të mbarë. Ruaj busullën duke menaxhuar sa më qetësisht kohën dhe situatat. Zhytem në mendime që më kthjellojnë, por në momente edhe mund të më turbullojnë apo ndryshojnë pikëvështrimin. Me vetëdisiplinë e evitoj nxjerrjen e vrerit, shkundjen e karakterit, madje edhe zvetënimin. Vetminë nuk e trajtoj si skëterrë, ankth, mallkim apo fundin tim. Përballem me vështirësi jo të lehta, por koncentrohem më tepër tek mundësitë minimale që ekzistojnë në këtë realitet ngulfatës. Vizualizoj kujtesën e përjetuar të gjërave të mira. Paralelisht, zhvilloj imagjinatën për të ardhmen më të mirë”, ka vazhduar Thaçi, duke shtuar se shumëllojshmëria e përvojës jetësore e ka rrëgjuar, duke dëgjuar e besuar me respekt, por edhe duke u gënjer dhe duruar në heshtje. “Shpresa në izolim është Zoti, gruaja dhe fëmija, nëna dhe babai, motra dhe vëllai, fqinji dhe miku. Është vetë jeta. Nuk arratisem nga vetvetja e as nuk zhvendosem apo tjetërsohem në botën ku të tjerët u përpoqën të më hedhin. Megjithëse edhe takimet dhe bisedat me familjarë nuk e kanë përjetimin apo ngrohtësinë emocionale normale. Këtu buzëqeshja nuk buron nga thellësia e shpirtit, zemrës dhe arsyes. Ushqimi që ha, kafja apo çaji që pi, nuk e kanë shijen origjinale. Çdo gjë duket e përkohshme, artificiale, sipërfaqësore, por në realitet ka vite të tëra thellësisht të shkëputura nga jeta e lirë. Bëj gjumë të rehatshëm, por nuk më sjell mjaftueshëm sensin e rigjenerimit mendor e as fizik. Me ndjenjën e vërtetë njerëzore i kam përjetuar

dhimbjet, lotët dhe ofshamat, deri tek përcjellja në TV e varrimit të babait. Çdo grusht dheu që hidhej në varrin e tij peshonte me ton mbi kokën time në qeli. Sjellja serioze apo heshtja në këtë mjedis nga të tjerët interpretohet si mërzë. Nga ana tjetër, moskokëçarja si arrogancë apo edhe budallallëk. Në realitet, pothuajse shumëçka është e rrejshme dhe mashtruese. Edhe ndryshimet atmosferike kalojnë pa lënë gjurmë. Shëtitja dhe ajrimi në poligonin sportiv, ku çdo ditë sillemi dhe risillemi, sikur ma heq saçin nga koka, ku çdo pore e trupit thith e përjeton frymëmarrje të thellë. Me të hapur sytë në mëngjes, dëgjoj muzikë pa tekst. Ëndrrat eventuale të natës i zëvendësoj me leximin e ndonjë rrëfimi libri apo gazete nga bota e filmit, artit, turizmit, historisë dhe kulturës, sportit e të tjera. Çdo agim mëngjesor e trajtoj si mundësi të re. Pema e vendosur në hapësirat e paraburgimit për festat e fundvitit më jep ngrohtësi të brendshme. E përcjell edhe ecurinë e botimeve të librave të rinj, disa prej të cilëve edhe i porosis përmes familjarëve. Vazhdoj me pirjen e kafesë, e cila më tepër më ka mbetur si gjest nga takimet gjatë punës në Prishtinë sesa nevojë kafeine. Gatimi i mëngjesit më jep kënaqësi dhe relaksion. Mundohem të përgatis gjëra sa më të shëndetshme. Tashmë më është bërë ritual. Një nga qëllimet e atyre që më sollën këtu është të bëjnë shkëputjen time nga jeta normale familjare, çrrënjosjen nga kujtesa e mjedisit qytetar dhe pamundësinë e jetës aktive institucionale. Thënë troç, kujtesën e mëhershme ta zëvendësojnë me kujtesë të re. Njerëzit nuk thonë kot: larg syve, larg zemrës. Një privim ky i ngadaltë dhe i butë. Sidoqoftë, Kosova është subjekti i këtij procesi dhe unë jam vetëm objekti. Bërthama e subjektit është duke u goditur ditë për ditë, rëndë e më rëndë. Por diçka harrohet: rezistenca kosovare është pika më e lartë e identitetit kombëtar dhe shtetëror. Rezistenca ndali rrjedhjen e mëtejshme të robërisë. Legjitimiteti i saj buron nga vullneti dhe qëllimi i drejtë i qytetarëve për liri. Është rrjedhojë e historisë me shkaqe e rrethana socioekonomike, kulturore, politiko-ushtarake, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka substancë, ka imazhin dhe kujtimin e gjallë lokal, kosovar, ndërkombëtar. Në pamundësi për teknikë moderne, përbalje të barabartë me Serbinë, ne e diplomatizuem lëvizjen e rezistencës dhe fituam. Historia e shtetbërjes së Kosovës nuk është dogmë apo diçka mekanike, as slogan, parullë, gazetë muri apo shkaravinë në dërrasë, e cila mund të gërvishtet apo shlyhet lehtë. Nuk është germa të shkruara në rërë, të cilat mbulohen nga tallazet e radhës së detit apo i



shkrumbojnë rrezet e diellit. Nuk ka mot që e ngrin apo që e than. Në pamundësi për ta shlyer historinë, kujtesën kolektive për rezistencën, lexoj gjëra dhe dëgjoj zëra në synimin e tyre për ta ndryshuar, për ta bërë mish-mash apo së paku ta zbehin, në mënyrë që më lehtë të çorientojnë njerëzit, të baraspeshojnë vlerën dhe antivlerën, të mirën dhe të keqen, të dobishmen dhe të dëmshmen. Të pretendosh për të bërë paralele mes rezistencës për liri dhe frymës së nënshtimit është sikur të barazosh dritën me errësirën. Dëshmitë e përjetuara qytetare janë testamenti i heroizmit, dhimbjes dhe shpirtit të lirisë. Procesi që po kalojmë nuk e glorifikon e as nuk e minimizon rolin personal të aktorëve udhëheqës të shtetbërjes. Vetëm dëshmon se nuk ishte udhëtimi i disa njerëzve të paudhë apo të dëshpëruar. Përkundrazi, kauzës së tyre i jep një dimension edhe më të lartë, edhe më të gjerë historik, politik dhe diplomatik, profil të suksesshëm, të papërjetuar dhe të papërsëritshëm në historinë e kombit tonë. Luftëtarët e lirisë nuk kanë nevojë ta mjegullojnë apo të fshihen nga e vërteta e rezistencës e as të kenë dilema për të ardhmen. Ata e kanë çimentuar rrëfimin e suksesit, i ndjek pas. Nuk vuajnë nga sindromi i kompleksit të mungesës apo inferioritetit. Nuk kanë brerje apo krisje ndërgjegjeje me veten e tyre përballë fëmijëve dhe familjes, thjesht trashëgimisë biologjike dhe kombëtare. Vlera e rezistencës është e mishëruar dhe integruar brenda gjithë shoqërisë sonë. Janë vlera të vazhdimësisë kombëtare dhe demokratike. Kujtesa e

rezistencës për liri dhe shtet është pergamenë në vetëdijen shqiptare, pastaj në arkivat e Uashingtonit, NATO-s e disa vendeve të tjera perëndimore. Për të keq, të ndyra dhe të rrejshme janë mbushur me dosje edhe arkivat në Beograd, Moskë e gjetiu nëpër hapësirat tona. Rezistenca i përket historisë. Sot e jetojmë realitetin e krijuar prej saj. E ka fillimin dhe mbarimin e qartë si kristali. E ka kohën, rrethanat dhe personazhet e veta për të kuptuar pa asnjë evazivitet rrugën e lirisë dhe shtetit të Kosovës. Shih rrëfimin e gjeneralit Wesley Clark gjatë dëshmisë së tij në Hagë. Aty kushdo e gjen prezantimin e drejtë të kauzës sonë, vlerat që përfaqëson sot, mesazhin dhe porosinë e rezistencës sonë për të ardhmen më të gjerë të botës së lirë. Në qeli nuk jam dhimbje apo gynah i gjallë kombëtar. Jam dëshmi e gjallë, ani pse po e paguaj me shpirtin dhe në lëkurën time. Nuk jam për t'u ngushëlluar. Lirinë kurrë nuk e kam marrë si të mirëqenë. Udhëtimin tim i kam dhënë drejtim vetë. Realitetet e krijuara më kanë konfirmuar zgjedhjen e duhur që kam bërë gjatë jetës. Kam sfiduar nëpër sprovë. I kam të kultivuara disa të shpejta si vetëtimat e disa të gjata, rraskapitëse. Për kohë të gjatë isha bërë urë. Kam toleruar që të kalojnë shumë përmes trupit tim, pa u lagur dhe pa therë në këmbë. Me të kaluar lumin, pastaj dihet: kanë mbyllur veshët të mos dëgjojnë, sytë të mos shohin, gojën për të mos folur. Thirrja e atdheut për liri dhe shtet i justifikonte të gjitha”, ka theksuar Thaçi.

(Intervista nuk është e plotë. Janë përzgjedhur vetëm disa pjesë)

Forcohet bashkëpunimi trepalësh Kosovë - Shqipëri - Kroaci në mbrojtjen e të dhënave personale

PRISHTINË, 5 MAJ - Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyra e Komisionarit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Shqipërisë dhe Agjencia Kroate për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilluan një takim dyditor të përbashkët pune, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe avancimin e qasjeve të përbashkëta në ushtrimin e mandateve përkatëse. Takimi shërbeu si platformë për

shkëmbim të strukturuar të përvojave dhe praktikave përmes prezantimeve të ndërsjella dhe diskutimeve mbi çështje konkrete, duke adresuar sfidat aktuale dhe nevojën për qasje të harmonizuara në nivel rajonal. Gjatë takimit u trajtuan, ndër të tjera: prezantimet mbi praktikën dhe instrumentet kryesore të autoriteteve në ushtrimin e mandatit; trajtimi i rasteve konkrete dhe zbatimit të standardeve në praktikë; përdorimi i sistemeve të vëzhgimit

me kamera dhe implikimet për privatësinë; mekanizmat e transparencës institucionale dhe balancimi me mbrojtjen e të dhënave; forcimi i zbatimit të ligjit dhe përgjigja ndaj zhvillimeve teknologjike.

Ky bashkëpunim trepalësh reflekton një orientim të përbashkët strategjik drejt forcimit të kapaciteteve institucionale dhe harmonizimit me standardet evropiane, në funksion të rritjes së besimit publik dhe mbrojtjes efektive të të dhënave personale.



DNV-ja: RREGULLORJA E RE E KQZ-së PËR VËZHUESIT KUFIZON VËZHIMIN E PAVARUR TË ZGJEDHJEVE

PRISHTINË, 5 MAJ - Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim" vlerëson se Rregullorja Zgjedhore nr. 04/2026 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 29 prill 2026, përmban dispozita që tejkalojnë kornizën e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe që cenojnë drejtpërdrejt mënyrën e ushtrimit të vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat e shoqërisë civile. "Ndryshe nga rregullativa paraprake, që akreditimin e organizatave vëzhguese e bazonte në verifikim formal të kërkesave ligjore, më rregulloren e re procesi kthehet në mekanizëm kufizues, pengues dhe kontrolli ndaj shoqërisë civile në vëzhgim të zgjedhjeve. Kjo rregullativë nuk buron nga ligji, dhe si e tillë cenon lirinë e asociimit dhe parimin e sigurisë juridike të organizatave. Për më keq, vetë procesi i hartimit dhe miratimit të kësaj rregulloreje është zhvilluar pa asnjë konsultim paraprak me organizatat e shoqërisë civile dhe pa asnjë njoftim publik. Konkretisht, rregullorja përmban dispozita [Neni 3.6] që kundërligjshëm i japin

mandat KQZ-së që të refuzojë akreditimin e një organizate vëzhguese mbi bazën e 'të dhënave nga institucionet kompetente për rrezik ndaj rendit juridik dhe kushtetues'. Kjo përgjegjësi nuk është në mandatin e KQZ-së, pasi që vetëm gjykatat kanë kompetencë për të vendosur për situata të tilla. Po ashtu, është shtuar dispozitë [Neni 3.4] që i japin KQZ-së autoritet përtej ligjit që, sipas vlerësimit të saj, të kërkojë dokumente shtesë lidhur me burimet e financimit të organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve. Vëzhgimi i zgjedhjeve nuk kushtëzohet me ekzistencën e fondeve të dedikuara, meqë e drejta për vëzhgim, si e drejtë qytetare mund të ushtrohet edhe mbi baza vullnetare. Për më tepër, çështja e burimit të financimit të OJQ-ve është e rregulluar me legjislacion tjetër, monitorimi i së cilave është në përgjegjësi të institucioneve tjera shtetërore", është thënë në komunikatën e DnV-së. Si kriter për akreditim të organizatave vëzhguese, Rregullorja [Neni 3.2] kërkon gjithashtu dorëzimin e të dhënave të detajuara, përfshirë themeluesit dhe strukturën drejtuese dhe raportet vjetore të OJQ-së, duke e zgjeruar



ndjeshëm gamën e informacionit që duhet dorëzuar për akreditim. "Ligji e përcakton qartazi që kriter për akreditim të organizatave është certifikata e regjistrimit dhe statuti i organizatës, përmes së cilave verifikohet fushëveprimi i organizatës, i cili duhet të jetë në fushën e zgjedhjeve apo të drejtave të njeriut. Në anën tjetër, me qëllim të ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor, DnV vazhdimisht ka rekomanduar që KQZ-ja të mos lejojë angazhimin e komisionerëve, stafit zgjedhor apo vëzhguesve

të cilët janë dënuar apo janë në procedurë hetimore për shkeljet zgjedhore. Sidoqoftë, në rregulloren e re [Neni 3.8] ky kufizim është përcaktuar vetëm për vëzhguesit, e jo edhe për komisionerët dhe stafin zgjedhor - që përbën diskriminim dhe cenim të parimit të barazisë para ligjit. Për më tepër, përgjegjësia për verifikim duhet të bjerë mbi KQZ-në dhe institucionet tjera publike, e jo tek organizatat vëzhguese apo vetë vëzhguesit. Në këtë Rregullore [Neni 8.4] është përcaktuar që vetëm organizatat e akredituara

vëzhguese mund të dërgojnë vëzhgues në takimet e KQZ-së dhe KKZ-ve. Kjo dispozitë është në shkelje të nenit 9 të Ligjit për Zgjedhje, i cili thekson se mbledhjet e KQZ-së janë të hapura për publikun, pa përjashtim, përpos rasteve kur diskutohet për çështje lidhur me personelin e KQZ-së", thuhet në komunikatën e DnV-së.

Demokracia në Veprim rikujton se vëzhgimi i zgjedhjeve është thelbësor për transparencën e procesit zgjedhor dhe për besimin e publikut në rezultatet e tij. Vendosija e kushteve dhe kërkesave shtesë përtej ligjit ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si realizohet vëzhgimi në praktikë, duke kufizuar hapësirën për vëzhgim dhe, për rrjedhojë, edhe nivelin e integritetit dhe legjitimitetit të procesit zgjedhor. "Për këto arsye, Demokracia në Veprim kërkon nga KQZ që sa më parë ta rishqyrtojë Rregulloren Zgjedhore nr. 04/2026, t'i largojë dispozitat që tejkalojnë bazën ligjore dhe të sigurojë që rregullimi i vëzhgimit të zgjedhjeve të mbështetet në standarde demokratike të qarta, të barabarta dhe të zbatueshme për të gjithë", theksohet në komunikatën DnV-së.

Votohet me 58 vota për raportin e PE-së për Shqipërinë

TIRANË, 5 MAJ - Është votuar të martën, më 5 maj, raporti i Parlamentit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025. Në mbledhjen e Komisionit për Punët e Jashtme eurodeputetët votuan me 58 vota për, 7 kundër dhe 7 abstenime. "Dua të kujtoj se Shqipëria është konsideruar nga komisionerja jonë Marta Kos një nga dy favoritët sa i takon zgjerimit", tha raportuesi për Shqipërinë në PE, Andreas Schieder, gjatë mbledhjes. Ai shtoi se në këtë raport kërkohet që reformat t'i prekin jetët e përditshme të njerëzve dhe që Shqipëria t'i japë më shumë

fokus situatës sociale. Në këtë raport të përgatitur nga Schieder, vlerësohet përparimi i vendit në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe theksohet rëndësia e reformave të mëtejshme për të garantuar një anëtarësim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm. Megjithatë, PE thekson se duhen reforma edhe më të thella dhe më të qëndrueshme, të cilat janë thelbësore për forcimin e institucioneve demokratike dhe për përmbushjen e kërkesave të BE-së. Po ashtu, Raporti vlerëson angazhimin e

Shqipërisë për integrimin në BE, duke theksuar konsensusin e gjerë ndërmjet partive politike dhe mbështetjen e fuqishme nga qytetarët për këtë proces. Shqipëria ka hapur të gjithë grupkapitujt e negociatave për anëtarësimin brenda 13 muajsh dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për reformën në drejtësi me vlerësim të veçantë punën e SPAK-ut. Një çështje kyçe konsiderohet nevoja për vijimin e punës në përmirësimin e sistemit zgjedhor bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias. Mes



të tjerash, raporti vlerëson angazhimin e Shqipërisë për politikën e jashtme të BE-së dhe stabilitetin rajonal, pasi

bashkëpunimi me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor shihet si një element kyç i procesit të zgjerimit.

PSD-ja kërkon nënshkrime nga qytetarët për të marrë pjesë në zgjedhjet e 7 qershorit

PRISHTINË, 5 MAJ - Partia Socialdemokrate (PSD) ka nisur një iniciativë për t'i mbledhur nënshkrimet nga qytetarët. Me mbledhjen e këtyre nënshkrimeve ata po kërkojnë pjesëmarrjen e këtij subjekti në zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 7 qershor. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë se kjo iniciativë nuk është mbështetje për votë, por për të qenë pjesë e garës në zgjedhje. Ai ka thënë se në këto zgjedhje do të garojnë për të qenë opozitë. "Kërkesa e njerëzve ka qenë në tri palë zgjedhje radhazi që Partia Socialdemokrate të

garojë. Tani kemi vendosur për të garuar në zgjedhje, qysh e patë edhe ju, mbështetja prej qytetarëve për garimin tonë nuk është mbështetje për votë, por është mbështetje që të jemi pjesë e kësaj gare. Rezultatit zgjedhor do ta vendosin qytetarët e Republikës së Kosovës. Ajo çka ne do të angazhohemi është se Kosovës i mungon opozita. Kosova nuk ka pasur opozitë qysh duhet në këto vite të qeverisjes Kurti, dhe ne e kemi shprehur tashmë qartë për herë të parë po ndodh në Kosovë që ne ekskluzivisht po garojmë për të qenë opozitë në mandatin e ardhshëm. Pra, ne nuk do të

jemi pjesë e qeverive, por do të garojmë për ulëse të opozitës", ka deklaruar Molliqaj. I pari i PSD-së ka shtuar se opozitën që mund ta bëjë kjo parti është më e afërta që i nevojitet Kosovës. "Besoj thellësisht se Kosova ka pasur opozitë të gabuar, edhe në kuptimin konceptual, por edhe të qasjes. Rezultati është parë, andaj besoj se vendit i duhet një opozitë tjetër. Ne si PSD jemi në garë me të gjithë. Jemi në garë edhe me Vetëvendosjen, edhe me PDK-në, edhe me LDK-në edhe me të tjerët, prandaj ne e kemi pozicionin tonë ekskluziv", ka shtuar Molliqaj.



HAPET ZYRTARISHT GJYKATA ADMINISTRATIVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 MAJ - Në kuadër të zhvillimit dhe avancimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës, të martën u bë hapja zyrtare e Gjykatës Administrative si institucion i ri në kuadër të sistemit gjyqësor, me qëllim të rritjes së efikasitetit, sigurimit të qasjes në drejtësi dhe forcimit të sundimit të ligjit në trajtimin e kontesteve administrative.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë përfaqësues të lartë institucionalë, përfshirë ushtruesen e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ministren në detyrë të Drejtësisë, anëtarë të Këshillit Gjyqësor, si dhe përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë nga Zyra e Bashkimit Evropian, EULEX-i dhe OSBE-ja. Të pranishëm ishin kryetarë të gjykatave dhe gjyqtarë.

Në fjalët e tyre folësit theksuan rëndësinë e themelimit të Gjykatës Administrative si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së cilësisë së vendimmarrjes dhe përmirësimit të besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

Zëvendëskryesuesja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Arjeta Sadiku, theksoi se themelimi i Gjykatës Administrative përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ajo shtoi se kjo gjykatë do të jetë e specializuar në shqyrtimin dhe vendosjen e çështjeve nga



konfliktet administrative, përfshirë edhe ato që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, duke ofruar një mekanizëm të pavarur, profesional dhe efikas të kontrollit gjyqësor mbi administratën publike.

Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, vuri në dukje se fillimi i punës së Gjykatës Administrative është ditë e rëndësishme për sistemin tonë të drejtësisë dhe përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të mbrojtjes efektive të të drejtave të qytetarëve.

Ndërkaq zëvendëskryeministrja

dhe ministrja e Drejtësisë në detyrë, Donika Gërvalla, sot mori pjesë në ceremoninë zyrtare të funksionalizimit të Gjykatës Administrative, gjykatë e parë e specializuar në Republikën e Kosovës.

Në fjalën e saj, ministrja Gërvalla tha se me funksionalizimin e Gjykatës Administrative po vihet në funksion një mekanizëm i ri i shtetit ligjor, duke e cilësuar ditën e sotme si një prej hapave të rëndësishëm në shërbim të një reforme të denjë, të thellë dhe të fuqishme në sektorin e drejtësisë.

"Gjykatë Administrative është gjykatë e parë e specializuar në vendin tonë, e cila do ta trajtojë

konfliktin administrativ dhe kontestet e punës në sektorin publik. Kjo do të thotë se qytetari, zyrtari publik dhe institucioni do të kenë një adresë të qartë, më profesionale dhe më të specializuar për çështjet që lidhen me administratën publike", u shpreh Gërvalla.

Ajo nënvizoi se administrata publike prek jetën e qytetarit çdo ditë përmes vendimeve, procedurave, lejeve, të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë, andaj çdo vendim administrativ duhet të jetë i ligjshëm, i arsyetuar dhe i kontrollueshëm. Më tutje, ministrja theksoi se Gjykatë Administrative po fillon punën me një barrë të madhe,

me mbi 10 mijë lëndë të bartura, e cila përbën sfida serioze, njëkohësisht edhe një mundësi për të dëshmuar se një gjykatë e specializuar mund të sjellë më shumë rend, shpejtësi dhe cilësi në drejtësinë administrative. "Vendimet tuaja nuk do të zgjidhin vetëm konteste individuale. Ato do të krijojnë standarde për administratën publike. Një vendim i mirë i kësaj Gjykatë nuk mbetet vetëm në dosjen e një pale, por ai duhet të shërbejë si orientim për zyrtarët publikë dhe si garanci për qytetarët", deklaroi ministrja Gërvalla drejtuar gjyqtarëve të pranishëm.

Teksa përgëzoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës për hapat e ndërmarrë në rekrutimin dhe transferimin e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës, ministrja Gërvalla theksoi se nga sot fokusi kalon te rezultatet. "Sot e kemi ligjin. E kemi gjykatën. Kemi gjyqtarët. E kemi pritjen e qytetarëve. Ajo që duhet të ndërtohet nga sot është besimi në këtë Gjykatë. Besimi nuk krijohet me ceremoni. Besimi krijohet me vendime të drejta. Me procedura të shpejta. Me praktikë të unifikuar. Me profesionalizëm dhe integritet", nënvizoi Gërvalla.

Duke uruar që në takimin e radhës të flitet për sukseset e Gjykatës së re Administrative, ministrja Gërvalla u zotua se Ministria e Drejtësisë do të jetë gjithmonë pranë për ta mbështetur gjyqësorin në këtë proces, bashkë me pritjen që kjo Gjykatë të prodhojë rezultate konkrete.

Regjistrimi i të porsalindurve tashmë pa procedura të lodhshme dhe pa dokumente fizike

PRISHTINË, 5 MAJ - Kryeministri në detyrë Albin Kurti në "Facebook" ka theksuar se qytetarët nuk kanë nevojë më të lëvizin nga një institucion në tjetrin për t'i përfunduar procedurat që lidhen me një ngjarje jetësore si ajo e

regjistrimit pas lindjes së fëmijës. "Të dhënat për të porsalindurin dhe prindërit regjistrohen në mënyrë digjitale përmes tabletit dhe më pas barten automatikisht në sistemet përkatëse që nga institucioni shëndetësor. Këto

të dhëna integrohen në sistemin shëndetësor, regjistrin civil, skemat e benefiteve për fëmijë dhe lehona, si dhe në institucionet e tjera relevante, duke eliminuar nevojën për dokumente fizike dhe aplikime

të ndara. Pas pilotimit të suksesshëm në Gjilan dhe Ferizaj, nga dje në Prishtinë e shumë shpejtë edhe në Prizren e Vushtrri, për të vazhduar më pas në Gjakovë, Pejë dhe gjithandej Republikës së Kosovës", ka shkruar Kurti.



Rriten të hyrat e qeverisë në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024

PRISHTINË, 5 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Llogaritë Qeveritare për vitin 2025. Ky publikim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe. Gjithsej të hyrat e qeverisë së përgjithshme në vitin 2025 ishin

3 508.1 milionë euro, ndërsa të hyrat në vitin 2024 ishin 3 222.7 milionë euro. Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 71 % të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura 15 %, aktivet dhe detyrimet financiare 4 %, ndërsa

pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave. Gjithsej shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në vitin 2025 ishin 3 485.6 milionë euro, ndërsa shpenzimet në vitin 2024 ishin 3 189.3 milionë euro. Pjesën më të madhe të

shpenzimeve e përbëjnë: kontributet sociale dhe përfitimet 27 %, kompensimi i punëtorëve 26 %, formimi i kapitalit bruto 14 %, konsumi i ndërmjetëm 14 %, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategoritë e tjera të shpenzimeve.



RAPORTI I FMN-SË NJEH PËRPARIMIN NË FORCIMIN E KORNIZËS SË STABILITETIT FINANCIAR TË KOSOVËS

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 5 MAJ - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka mirëpritur publikimin e Raportit të Asistencës Teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Republic of Kosovo: Financial Sector Stability Review - Follow-up", të përgatitur nga Departamenti për Tregje Monetare dhe të Kapitalit i FMN-së, pas misionit përcjellës të FSSR-së, të realizuar me kërkesë të BQK-së.

Raporti njeh përparimin e rëndësishëm të arritur nga BQK-ja në forcimin e mbikëqyrjes së sektorit financiar, mbikëqyrjes së bazuar në rrezik, zbatimin e procesit të rishikimit dhe vlerësimit mbikëqyrës (SREP/SRP), testimin të qëndrueshmërisë, politikës makroprudenciale dhe qeverisjes institucionale. Po ashtu, raporti konfirmon se sistemi financiar i Kosovës mbetet përgjithësisht i

qëndrueshëm, me banka të mirëkapitalizuara, nivel të ulët të kredive joperformuese dhe rezerva të likuiditetit mbi kërkesat rregullative.

Raporti i FMN-së thekson se, që nga FSSR i parë, BQK-ja ka avancuar reforma të rëndësishme, përfshirë forcimin e mbikëqyrjes bankare të bazuar në rrezik, avancimin e kornizës së SREP, zbatimin e standardeve rregullative të ndërlidhura me Basel III, si Raporti i Levës, LCR dhe NSFR, si dhe aktivizimin e instrumenteve makroprudenciale. Raporti, gjithashtu, njeh përparim në vendosjen e kornizës makroprudenciale, përfshirë përcaktimin e Bankave me Rëndësi Sistemike Vendore dhe vendosjen e Shtesës Kundërciklike të Kapitalit.

Raporti më tej vlerëson përparimin e BQK-së në forcimin e aranzhimeve institucionale, kapaciteteve mbikëqyrëse, analizës së stabilitetit financiar dhe



kornizave për gatishmëri ndaj krizave, duke ofruar një udhërrëfyes të qartë teknik për fazën e ardhshme të reformave.

Këto rekomandime do t'i mbështesin përpjekjet e vazhdueshme të BQK-së për të avancuar më tej efektivitetin

mbikëqyrës, monitorimin e rreziqeve sistemike, infrastrukturën e të dhënave, politikën makroprudenciale dhe qëndrueshmërinë e sektorit financiar.

BQK-ja shpreh mirënjohjen për Fondin Monetar Ndërkombëtar, Departamentin për Tregje Monetare dhe të Kapitalit, ekipin e misionit të FSSR-së, si dhe donatorët e Fondit për Stabilitetin e Sektorit Financiar (FSSF), mbështetja e të cilëve ka kontribuar në avancimin e asistencës teknike dhe zhvillimit të kapaciteteve në fusha kyçe të stabilitetit financiar.

BQK-ja mbetet e përkushtuar për zbatimin e reformave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e Bashkimit Evropian, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar, forcimin e qëndrueshmërisë institucionale dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit financiar në Republikën e Kosovës.

DHTIK DHE BQK DISKUTOJNË PËR TEMA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK



PRISHTINË, 5 MAJ - Drejtuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë janë prituri në takim nga guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, me të cilin është diskutuar për një numër temash që i shqetësojnë bizneset. Kryetari i Bordit të DHTIK-së, Skënder Krasniqi, ka përmendur sfidat kryesore të bizneseve për qasje në financa, problematikën që lidhen me sektorin e sigurimeve, përfshirë Kartonin e Gjellbër dhe çështje të tjera që ndërlidhen me kompetencat e BQK-së.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i Dhomës, Kushtrim Ahmeti, ka shprehur shqetësimin se shkuarja sërish në zgjedhje po i kushton drejtpërdrejt ekonomisë, pasi ligje kyçe për zhvillimin ekonomik, përfshirë SEPA-n, kanë mbetur të bllokuara. Ai ka thënë se, pavarësisht prej thirrjeve të vazhdueshme, partitë politike nuk kanë pasur vullnetin t'i përmbyllin këto ligje para se të shpërndahej kuvendi. Ndërkaq guvernatori Ismaili ka falënderuar drejtuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë

Kosovë për takimin dhe ndarjen e informacioneve për sfidat që po përballen bizneset me sektorin financiar. Ai ka bërë me dije se BQK-ja është duke u angazhuar në një numër reformash dhe aktiviteteve nga të cilat do të përfitojnë ekonomia dhe bizneset në përgjithësi.

Të dyja palët kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet tyre, institucioneve financiare dhe komunitetit të biznesit me qëllim të adresimit të sfidat aktuale dhe zgjidhjes së tyre.

Shmanget shtrenjtimi i rrymës, ZRRE-ja ndryshon të hyrat maksimale të operatorëve

PRISHTINË, 5 MAJ - Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka miratuar pjesërisht kërkesat për të hyrat e operatorëve të kësaj fushe, duke shmangur shtrenjtimin e energjisë elektrike. Kësisoj, të hyrat e lejuara maksimale të Operatorit

të Sistemit të Transmetimit (KOSTT) nga sot do të jenë 76 milionë euro, të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) 185 milionë euro dhe për Furnizuesin me Shërbim Universal (KESCO) 442 milionë euro.

Këto ndryshime të të hyrave maksimale u morën në mbledhjen e ZRRE-së, me arsyetimin që të mos rrezikohet siguria e furnizimit apo mos prodhimit nga gjeneratorët vendorë. Muharrem Gashi nga

Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve u arsyetua se me rritjen e importit duhet ndryshuar të hyrat maksimale. Kërkesa nga KOSTT-i ka qenë rreth 99 milionë euro, 23 për qind më e lartë sesa vlera e vendosur nga ZRRE-ja.



IZRAELI NUK MUND TË VAZHDOJË TË JETOJË DUKE PËRDORUR VETËM FORCËN

Nga Gideon LEVY

Më 22 prill, Izraeli festoi 78-vjetorin e pavarësisë së tij. Sigurisht që nuk ishte më i miri në historinë e një vendi që tashmë nuk është më i ri.

Kur isha fëmijë, dita e pavarësisë ishte një moment krenarie dhe gëzimi për të gjithë izraelitët e rinj si unë. Kishin kaluar vetëm pak vite nga Holokausti dhe nga themelimi i shtetit hebre, dhe ne ishim fëmijët e brezit të parë të banorëve të tij. E kujtoj babanë tim teksa nxirrte nga sirtari flamurin e palosur dhe e ngrinte në ballkonin e apartamentit tonë. Të gjithë ballkonet përreth kishin flamurin e tyre, përveç atij të familjes Lebel, sepse ata ishin ultra-ortodoksë dhe nuk e nderonin shtetin sionist.

Unë ndieja për babanë, të njëjtën krenari që ndieja për flamurin.

Në ato vite nuk dinim asgjë për Nakbën, "katastrofën", kur qindra mijëra palestinezë u detyruan të linin shtëpitë e tyre pas lindjes së Izraelit në vitin 1948. Askush nuk na kishte folur për këtë. Ashtu sikurse askush nuk na kishte treguar për regjimin ushtarak nën të cilin jetonin qytetarët arabë të Izraelit. Nuk pyesnim kurrë se kush kishte jetuar në shtëpitë e shkatërruara buzë rrugës, apo çfarë kishte ndodhur me ata njerëz. Shikonim mbetjet e fshatrave dhe lagjeve palestineze, sikur të ishin thjesht pjesë e peizazhit. Në mbrëmje dilnim në rrugë për të festuar. Dita e pavarësisë ishte e vetmja ditë kur prindërit tanë na lejonin të qëndronim jashtë deri vonë, pa asnjë kufizim. Ishte një festë kombëtare.

Që atëherë kanë kaluar dekada, dhe gjithçka duket ndryshe. Fjala Nakba ka hyrë gradualisht në ndërgjegjen publike, edhe pse vetëm tek një pakicë e vogël izraelitësh. Një pakicë edhe më e vogël ka filluar të ketë një ndjenjë faji historik.

Ndërkohë, ngjarjet e viteve të fundit kanë bërë që disa prej nesh të turpërohen nga shteti ynë. M'u deshën vite për të kuptuar se ngjarjet e fundit dhe ato të një të kaluarë të largët nuk mund të ndahen. Në themel të vendit tonë qëndron Nakba. Dita në të cilën ne festonim pavarësinë ishte dita kur një popull tjetër kujtonte një katastrofë, i njëjti popull që banonte në këto toka para nesh. Që atëherë, gjithçka mbetet e lidhur ngushtë me të kaluarën. Ajo që nisi në vitin 1948 nuk ka përfunduar ende, as në vitin 2026. Nga Nakba e deri më sot, parimet themelore të ndjekura nga sionizmi kanë mbetur të pandryshuara, ashtu si edhe politikën e qeverive izraelite. Nakba nuk ka mbaruar kurrë. Ajo vetëm ka ndryshuar formë. Sado e frikshme të jetë ta mendosh, vlerat që 78 vite më



parë sollën Nakbën vazhdojnë të përbëjnë themelin e shtetit hebre. Të njëjtat parime. Të njëjtat objektiva. Të njëjtat metoda.

Izraeli tashmë është një fuqi rajonale dhe aleati më i afërt i superfuqisë më të madhe botërore, por nuk ka ndryshuar nga koha kur ishte një shtet i sapolindur: Ai ende beson se mund të mbijetojë me shpatë, dhe vetëm me shpatë.

Vendi ynë vazhdon ta shohë fuqinë ushtarake si garancinë e vetme të ekzistencës dhe sigurisë së tij, duke ndjekur një politikë të bazuar në supremacinë hebraike në të gjithë hapësirën mes Detit Mesdhe dhe lumit Jordan. Ai paraqitet si viktimë, një fuqi rajonale që flet pa pushim për kërcënime ekzistenciale. Izraelitët janë ende të bindur se drejtësia absolute është në anën e tyre. Se të gjithë arabët lindin për të vrrarë. Dhe se e vetmja gjë për të cilën mendojnë popujt e botës arabe është t'i hedhin hebrejtë në det. Të njëjtat bindje. Të njëjtat parime të vitit 1948.

Nën sipërfaqe, ndërkohë, fermentojnë bindje fetare që në 78 vjet janë bërë edhe më të forta: Se Zoti ua ka dhënë këtë tokë hebrejtë, dhe vetëm atyre. Një premtime biblik që vlen si akt pronësie dhe certifikatë hyjnore sovraniteti, edhe në sytë e hebrejtë që e quajnë veten laikë.

Izraeli, parimet kanë mbetur të njëjta

Parimet kanë mbetur të njëjta. Por disa gjëra kanë ndryshuar që nga pavarësia. Dhe shumë rrallë kanë ndryshuar për mirë.

Ankimi i shumë izraelitëve që sot ndjejnë nostalgji për Izraelin e vjetër, atë para se Likud-i i

Benjamin Netanyahu të merrte pushtetin, është në masë të madhe një iluzion, një akt vetëmashtrimi. Nuk ishte Netanyahu ai që shpiku pushtimin. Nuk ishte partia e tij që solli supremacinë hebraike. Të dyja ekzistonin tashmë në Izraelin e vjetër, në socializmin e Partisë Laburiste dhe në "pushtimin e ndriçuar".

Pas vitit 1948 dhe pas vitit 1967, 7 tetori 2023 shënoi një tjetër pikë dramatike kthese. Në dy vjet e gjysmë që kanë kaluar që nga ajo datë, Izraeli ka eliminuar një pjesë të madhe të liderit rajonal, ka pushtuar dhe bombarduar pothuajse të gjithë vendet fqinjë, dhe ka çliruar forcën e tij ushtarake pa asnjë ndjenjë mase, duke u njollosur me krime lufte në shkallë të gjerë.

Megjithatë, në 78-vjetorin e pavarësisë, vetëm pak izraelitë e kanë pranuar këtë realitet të pamohueshëm. Me sa duket, në vendin tim nuk do të ketë kurrë një komision të së vërtetës dhe pajtimit si ai i Afrikës së Jugut, sepse nuk ekziston një dëshirë e sinqertë për reflektim.

As për transformimin e Izraelit në një shtet të përjashtuar për një pjesë të madhe të komunitetit ndërkombëtar. Në diskursin publik, pyetja: "Pse bota na urren?" trajtohet si e paligjshme. Përgjigja është: "Sepse e gjithë bota është antisemitike." Fund i diskutimit. Ky ishte humori që mbizotëroi në 78-vjetorin e pavarësisë. Izraeli nuk ka qenë kurrë një demokraci e vërtetë. Dhe përvjetori i pavarësisë ishte momenti i duhur për ta thënë qartë. E vetmja periudhë kur palestinezët nuk ishin nën sundim ushtarak zgjati vetëm disa muaj, mes viteve 1966 dhe 1967. Deri atëherë, kontrolli ushtarak zbatohet mbi qytetarët arabë të Izraelit.

Më pas, ai u zbatua në territoret e pushtuara të Rripit të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Një shtet me regjim ushtarak të përhershëm nuk është demokraci. Pikë.

E njëjta gjë vlen edhe për aparteidin. Ai nuk lindi vitet e fundit. Ai lindi në ditët e para të shtetit hebre, dhe u forcua fuqishëm pas pushtimit të vitit 1967. Gjatë gjithë historisë së tij, para vitit 1967 dhe sigurisht pas tij, Izraeli nuk e ka pranuar kurrë idenë se palestinezët kanë të njëjtat të drejta si hebrejtë izraelitë në tokën mes Jordanit dhe detit. Dhe, ç'është më e rëndësishmja, Izraeli nuk i ka konsideruar kurrë palestinezët si qenie njerëzore të barabarta me hebrejtë. Kjo mbetet rrënja e problemit. Dhe askush nuk flet për të.

I vetmi ndryshim thelbësor që ka dalë në pah vitet e fundit është se një megalomani e re izraelite ka zëvendësuar frymën e vjetër të Davidit (Izraeli) kundër Goliathit (arabëve). Kjo megalomani arriti kulmin pas 7 tetorit 2023. Sot izraelitët duket qartë se janë të bindur se gjithçka u lejohet.

Ata nuk njohin më asnjë kufi në përdorimin e forcës ushtarake apo në shpërfilljen e sovranitetit të shumicës së shteteve të rajonit. Në këtë ditë pavarësie, një re e zezë rëndon mbi qiellin gjithnjë e më të errët të Israel. Shoqëria është e përçarë vetëm për një çështje: Netanyahu, po apo jo Netanyahu. Pothuajse gjithçka tjetër është përjashtuar nga debati, sepse për temat e tjera, me sa duket, ekziston një konsensus i plotë.

Nuk ekziston asnjë opozitë hebraike kundër luftës, kundër pushtimit apo kundër aparteidit.

Rripi i Gazës shqetëson vetëm pak njerëz. Po kështu edhe Bregu Perëndimor, i

transformuar brutalisht në mbulesën e luftërave të tjera të fundit në rajon. Në Bregun Perëndimor, duke u mbështetur te dhuna e kolonëve dhe te një ushtri që i mbështet, shteti hebre ka zhdukur çdo shpresë të mbetur për një shtet palestinez. Por edhe kjo, në Izrael, u intereson shumë pak njerëzve. Pa debat dhe pa një shqyrtim të ndërgjegjes, ndjesia është se qielli mbi Izrael po bëhet gjithnjë e më i errët.

Edhe propagandistët më të zhurmshëm të së djathtës fashiste kanë filluar të kuptojnë përmasën e kërcënimit që sot rëndon mbi shtetin, pasi qeveria ka hapur shumë fronte lufte pa arritur objektivat e saj në asnjërin prej tyre. Rripi i Gazës dhe Libani nuk janë histori suksesi. Janë luftëra të panevojshme dhe kriminale, që nuk i kanë sjellë asnjë përfitim Tel Avivit, por vetëm një kosto të lartë që, me kalimin e viteve, mund të rezultojë e papërballueshme.

Shtetet e Bashkuara po çlirohen ngadalë nga shtrëngimi i Izraelit, deri në atë pikë sa edhe Donald Trumpi mund t'i kthejë shpinën. Në çdo rast, presidenti që do ta zëvendësojë pas më pak se tre vitesh, qoftë demokrat apo republikan, me siguri do të ndjekë një politikë ndryshe ndaj këtij aleati. Ditët kur Izraeli i kishte Shtetet e Bashkuara në xhep kanë përfunduar. Ndoshta përgjithmonë.

Edhe Europa po pret një sinjal nga Uashingtoni për të ndryshuar politikën e saj. Kontinenti i vjetër po humbet durimin ndaj një shteti pushtues, agresiv dhe megaloman. Vitet e fundit nuk kanë qenë pozitive për Izraelin. Ai ka vazhduar të nisë luftëra, të pushtojë territore dhe të detyrojë njerëzit të lënë shtëpitë e tyre. (Sot refugjatët në Lindjen e Mesme si pasojë e luftërave izraelite janë rreth 6 milionë, dhe shumë prej tyre nuk kanë më një vend ku të kthehen.)

Por duke vepruar kështu, Izraeli ka komprometuar pozicionin e tij ndërkombëtar.

Një shtet që i ka treguar gishtin e mesit të gjitha institucioneve globale, të gjitha rezolutave, të drejtës ndërkombëtare dhe opinionit publik të vendeve aleate, po ecën në një rrugë që çon drejt një izolimi të ngjashëm me atë të Afrikës së Jugut të aparteidit. Dhe është një trajektore shumë e vështirë për t'u ndryshuar.

Gideon Levy është gazetar izraelit. Shkruan për gazetën Haaretz. Ky artikull është botuar fillimisht në Middle East Eye. (Bota.al)




Evertoni kontakton Juventusin për Zhegrovën

PRISHTINË, 5 MAJ - Skuadra e Evertonit ka ndërmarrë hapa konkretë në lidhje me transferimin e Edon Zhegrovës, kanë raportuar të martën mediet angleze. Është bërë me dije se Juventusit ka kontaktuar

Juventusin në lidhje me Zhegrovën, e ardhmja e të cilit nuk është e sigurt te skuadra italiane. Evertoni po insiston për Zhegrovën, por dëshiron huazimin e tij për sezonin e ardhshëm dhe me opsionin e blerjes pas një

viti. Te skuadra e Juventusit ende nuk kanë marrë një vendim të prerë për Zhegrovën, i cili ka kontratë me skuadrën italiane deri në vitin 2030. Verën e shkuar Zhegrova i është bashkuar Juventusit nga Lille, por në

sezonin e tij të parë ka pasur pak minuta me fanellën e skuadrës nga Seria A. 27-vjeçari deri më tani ka regjistruar 24 paraqitje për Juventusin në të gjitha garat apo në total ka vetëm 485 minuta lojë.



PRISHTINA E RE - PRISHTINA HAP XHIRON E 33-të NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 5 MAJ - Ndeshja Prishtina e Re - Prishtina shënon hapjen e xhiros së 33-të në Superligën e Kosovës në futboll. Kjo është ndeshja e vetme e kësaj xhiroje që luhet në mesjavë, pasi duelet e tjera do të zhvillohen në fundjavë. Kjo përballje zhvillohet sot (e mërkurë) prej orës 15:00 në Kampin Nacional të FFK-së në

Hajvali. Të dyja skuadrat nuk kanë treguar formë të mirë javët e fundit në Superligë dhe do të tentojnë që në këtë përballje të rikthehen te rezultatet pozitive. Prishtina e Re është e fundit në tabelë me 28 pikë dhe vështirë se mund ta sigurojë mbijetesën në elitë, ndërsa ka regjistruar humbje në tri xhirot e fundit. Prishtina,

në anën tjetër, në gjashtë xhirot e fundit ka 4 barazime dhe 2 humbje, kurse zë vendin e katërt në tabelë me 45 pikë. Duelet e tjera të kësaj xhiroje luhet të shtunën dhe të dielën, me fillim nga ora 16:00, kurse do të përballen Drenica - Gjilani, Drita - Ballkani, Llapi - Dukagjini dhe Ferizaj - Malisheva.



GRANIT XHAKA I PROPOZOHET MANCHESTER UNITEDIT

SUNDERLAND, 5 MAJ - Manchester Unitedi është "urdhëruar" nga ish-portieri Michael Schmeichel për ta transferuar Granit Xhakën në afatin kalimtar të verës. Unitedi pritet të forcohet në mesfushë për sezonin e ardhshëm dhe Xhaka po shihet si lojtari ideal për ta forcuar repartin e mesfushës. Braziliiani Casemiro pritet të largohet nga klubi anglez pasi në fund të sezonit i skadon kontrata dhe Schmeichel ka

insistuar të tentohet transferimi i Xhakës. Sipas tij, Xhaka është i duhuri për mesfushën e Unitedit duke pasur parasysh përvojën dhe paraqitjet e mira që i ka treguar këtë sezon me fanellën e Sunderlandit. "Mendoj se duhet ta transferojnë Xhakën pasi është një lider i vërtetë dhe ka cilësi të mëdha. Kur e shoh se çfarë ka bërë Xhaka për Sunderlandin, atëherë me bindje të plotë them se

Unitedi ka nevojë për të. Xhaka do t'i sillte energji edhe zhveshtoresh dhe ka fuqinë mbi lojtarët e tjerë, që është e rrallë. Unitedi ka nevojë urgjente për një lidhshmëri të tillë", ka insistuar Schmeichel. 33-vjeçari verën e shkuar i është bashkuar Sunderlandit, ku edhe është kapiten, kurse ka kontratë deri në verën e vitit 2028. Në 31 paraqitje këtë sezon në Premierë Ligë, Xhaka ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 6 asistime.

BASHAKSHEHIRI INTERESOHET PËR MILOT RASHICËN



Beshiktash, 5 maj - Milot Rashica këtë verë përfundimisht do të largohet nga skuadra e Beshiktashit, por jo edhe nga Superliga e Turqisë. Mediumet turke kanë raportuar të martën se është skuadra e

Bashakshehirit që ka shprehur interesim për shërbimet e Rashicës. Është thënë se trajneri Nuri Sahin e pëlqen shumë sulmuesin e krahut dhe ka kërkuar nga drejtuesit e Bashakshehirit që të tentojnë

transferimin e tij. Beshiktashi tashmë e ka nxjerrë në shitje Rashicën dhe Bashakshehiri është i gatshëm të ofrojë deri në 3.5 milionë euro për kartonin e tij. Rashica ka kontratë me Beshiktashin deri në vitin e

ardhshëm, ndërsa është pjesë e ekipit prej verës së vitit 2023. Aktualisht Rashica është i lënduar, kurse këtë sezon ka shënuar 2 gola dhe ka bërë 6 asistime në 33 paraqitje në të gjitha garat për Beshiktashin.

Mourinho, favorit për ta marrë drejtimin e Real Madridit

Madrid, 5 maj - Jose Mourinho po rikthehet në krye të skuadrës së Real Madridit, kanë raportuar të martën mediumet në Spanjë dhe Portugali. Në fakt është thënë se Mourinho është favoriti kryesor për t'u emëruar trajner i Real Madridit me të

përfunduar sezoni aktual. Madje është thënë se tashmë ka kontakte mes të gjitha palëve, Real Madridit, Mourinhos dhe Benficas, ekip me të cilin trajneri portugez ka kontratë deri në vitin 2027. Drejtuesit e Realit tashmë kanë njoftuar Benfican se do të bisedojnë

me Mourinhon, i cili ka shprehur gatishmërinë e plotë për t'u kthyer në "Santiago Bernabeu". Mourinho në krye të Real Madridit do ta zëvendësonte Alvaro Arbeloa, i cili do të largohet me të përfunduar sezoni dhe është njoftuar

nga klubi se nuk do t'i vazhdohet kontrata. Arbeloa është emëruar trajner i përkohshëm i Real Madridit pas largimit të Xabi Alonsos, ndërsa Mourinho ka qenë për tri vjet në krye të ekipit spanjoll, prej vitit 2010 deri në vitin 2013.





Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government
 Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
 Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
 Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 06.05.2026

Referenca: AAPSK – 004/2026

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

N r	Përshkrimi	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi fillestar	Çmimi nga ofertuesi
1	Vilë model 'El Profesor' P+NK- Rishpallje	100.48 m ²	11,191.00€	
2	Vilë model 'Zyre' P+0- Rishpallje	42.2 m ²	4.700.00€	
3	Vilë model 'Berlin Deluxe' P+1- Rishpallje	101.67 m ²	11,322.80€	
4	Vilë model 'Golden' P+NK- Rishpallje	37.63 m ²	4.191.00€	

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri me **12.05.2026** në ora **11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë-Ferizaj- KK Graçanicë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **12.05.2026**, prej orës **10:00-11:00** në Zonën Kadastrale, Çagllavicë,-në adresë: IT Group Shpk Maxhistrala Prishtinë- Ferizaj- KK Graçanicë.

Pasuritë e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin

dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 12:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bavaria Bau” SH.P.K. pronar Gent Sejdiu me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812006973 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bavaria Bau” D.O.O. Gent Sejdiu Gnjilane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812006973 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bavaria Bau” L.L.C. with owner Gent Sejdiu with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812006973 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Diellëzon Krasniqi nga Damjani i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Kongresi i Manastirit”, Damjan, nga klasa 1-5 dhe 6-9.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm u “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfm u “ Zef Lush Marku” Velezhe.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “FehmiAgani” Gjakovë me numër 200102037.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

